



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
MINISTRI

Nr. 16291/Prot.

Tiranë, më 15.10.2019

URDHËR

Nr. 370/ Datë 15.10.19

PËR

**“PËRCAKTIMIN E SHËRBIMEVE TË TJERA SHITESË QË OFROHEN NGA QENDRA
KOMBËTARE E BIZNESIT DHE TARIFAT PËRKATËSE PËR KËTO SHËRBIME”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar, të nenit 19, të Kodit të Procedurave Administrative, nenit 11, të Ligjit nr. 131/2015, “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, nenit 28, të Ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”,

URDHËROJ:

1. Përcaktimin e shërbimeve të tjera shtesë që ofrohen nga Qendra Kombëtare e Biznesit në mbështetje të funksioneve të përcaktuara në ligjin nr. 131/2015, dhe tarifave përkatëse të shërbimeve të tjera shtesë, sipas Lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij urdhëri.
2. Në rastet kur, informacioni/ dokumentacioni kërkohet përpara afatit të përcaktuar Lidhjen nr. 1, subjekti/individ i kërkues paguan dyfishin e tarifës përkatëse për shërbimin.
3. Nëse shërbimi i kërkuar nuk është i identifikuar në Lidhjen 1:
 - a) dhe, kosto e përlogaritur e shërbimit është më e lartë se vlerat në tabelë për shërbime të ngjashme me atë të kërkuar, tarifa është sa dyfishi i tarifës së vlerës së shërbimit të ngjashëm;
 - b) dhe, kosto e përlogaritur është më e ulët se tarifa për shërbimet e ngjashme, tarifa është sa vlera më e ulët e kësaj table.
4. Personat dhe subjektet e interesuara paguanë tarifën përkatëse për llogari të Qendrës të Kombëtare të Biznesit, përpara paraqitjes së kërkesës për marrjen e shërbimit.

5. Përfshihen nga tarifimi për shërbimet dytësore që ofrohen nga QKB, institucionet përfituese buxhetore.
6. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Qendra Kombëtare e Biznesit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.



Lidhja nr. 1

Nr.	Emërtimi i shërbimit dytësor	Vlera në lekë	Afati për dhënien e informacionit/ shërbimit
1.	Statistika mbi regjistrimet e reja të subjekteve për një periudhë kohore deri 1 vjeçare.	4 500	2 ditë pune
2.	Statistika mbi numrin e çregjistrimeve të subjekteve tregtare për një periudhë kohore deri 1 vjeçare.	2 500	2 ditë pune
3.	Statistika mbi numrin dhe listën e çregjistrimeve të subjekteve tregtare për një periudhë kohore deri 1 vjeçare.	4 500	2 ditë pune
4.	Raport mbi pronësinë (duhet specifikuar forma) e subjekteve tregtare: - Shqiptare (100%) - E Përbashkët (shqiptare – e huaj) - E Huaj (100%) - Shtetërore shqiptare	4 500	2 ditë pune
5.	Raport mbi numrin e subjekteve të regjistruar mbi gjininë e administratorëve/ortakëve/aksionarëve: - Femër - Mashkull	3 500	2 ditë pune
6.	Raport mbi shtetësinë (vetëm për një shtetësi) e ortakëve /aksionarëve/ administratorëve të subjekteve;	1 500	2 ditë pune
7.	Raport mbi shtetësinë (nga 2 deri në 6 shtetësi)	4 500	2 ditë pune

	të ndryshme) e ortakëve/ aksionarëve/administratorëve të subjekteve;		
8.	Raport mbi shtetësinë (mbi 6 shtetësi të ndryshme) e ortakëve/ aksionarëve/administratorëve të subjekteve;	6 500	2 ditë pune
9.	Raport mbi formën ligjore (duhet specifikuar forma) të subjekteve të regjistruara në QKB: - Person Fizik - SHPK - SHA - Degë e Shoqërisë së huaj - Shoqëri Kolektive - Shoqëri e thjeshtë - Shoqëri komandite - Shoqëri kursim krediti - Shoqëri me bashkëveprim reciprok -Zyrë Përfaqësimi	5 500	2 ditë pune
10.	Raport rreth një objekti aktiviteti, të subjekteve të regjistruara në QKB	3 500	2 ditë pune
11.	Raport mbi numrin e bilanceve të depozituara në QKB.	4 000	2 ditë pune
12.	Raport mbi depozitimin e bilanceve në regjistrin tregtar në formatet SKK2 (duke filluar nga viti 2018 për një nga format) - Bilanc INFO - Bilanc Total - Pash (Natyra) - Pash Total (Natyra) - Pash (Funksion) - Pash Total (Funksion)	6 500	2 ditë pune
13.	Raport mbi depozitimin e bilanceve në regjistrin tregtar në formatet SKK15(duke filluar nga viti 2018 për një nga format) - Bilanc INFO - Bilanc Total - Pash (Natyra) - Pash Total (Natyra) - Pash (Funksion) - Pash Total (Funksion)	5 000	2 ditë pune
14.	Raport mbi depozitimin e bilanceve në regjistrin tregtar në formatet SNRF (duke filluar nga viti 2018 për një nga format) - Bilanc INFO - Bilanc Total - Pash (Natyra)	6 500	2 ditë pune

	- Pash Total (Natyra) - Pash (Funksion) Pash Total (Funksion)		
15.	Raport mbi bilancet për një numër të caktuar subjektsh të përmendura nominalisht (deri në 20 subjekte të ndryshme).	5 000	2 ditë pune
16.	Raport mbi bilancet për një numër të caktuar subjektsh të përmendura nominalisht (mbi 20 deri 100 subjekte të ndryshme).	6 000	2 ditë pune
17.	Raport mbi pasqyrat financiare të depozituara në regjister (gjenerim i pasqyrave) për një vit kalendarik	10 000	10 ditë pune
18.	Raport mbi xhiron vjetore të deklaruar në pasqyrat financiare ose aktivet e një numri të caktuar subjektsh.	5 000	2 ditë pune
19.	Raport mbi subjektet tregtare që operojnë në një Qark/Bashki të caktuar.	5 000	2 ditë pune
20.	Statistika mbi aplikimet për Leje, Licenca në një periudhë të caktuar.	5 000	2 ditë pune
21.	Statistika mbi Leje, Licencat e lëshuara në një periudhë të caktuar, me statuset aktuale në Regjistrë.	5 000	2 ditë pune
22.	Raport mbi Leje, Licencat e lëshuara në një periudhë deri në 1 vit, me statuset aktuale të Leje, Licencës.	5 000	2 ditë pune
23.	Raport mbi Leje, Licencat që kanë një objekt aktiviteti të përcaktuar.	5 000	2 ditë pune
24.	Raport tabelar mbi statuset e aplikimeve të kryera për Leje, Licenca në një periudhë të caktuar.	5 000	2 ditë pune
25.	Raport mbi Licencat, Lejet e lëshuara në një Qark/Bashki të caktuar, me statuset aktuale të Lejes, Licencës.	5 000	2 ditë pune
26.	Zëvendësimi i titullit të licencave/lejeve	100	Menjëherë
27.	Kopje të vërtetuara të akteve të depozituara nga regjistri licencave/lejeve deri në 20 fletë	100	2 ditë pune
28.	Kopje të vërtetuara të akteve të depozituara nga regjistri licencave/lejeve nga 21 fletë deri në 100 fletë	500	2 ditë pune
29.	Kopje të vërtetuara të akteve të depozituara nga regjistri licencave/lejeve mbi 100 fletë	1 000	2 ditë pune
30.	Kopje të vërtetuara të akteve të depozituara nga regjistri licencave/lejeve mbi 300 fletë	2 000	3 ditë pune